



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**  
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL IV/2023**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

**Vendi:** Suharekë  
**Zyra:** Salla e Kuvendit të Komunës  
**Data:** 27.04.2023  
**Ora:** 10.00

---

**Prezentë në takim:**

**Z. Shefket Kolgeci**

**Z.Selman Kolgeci**

**Z. Flamur Bytyçi**

**Z. Urim Suka**

**Z. Kushtrim Kuçi**

**Znj. Elmaze Bytyqi**

**Znj. Bulëza Kuçi**

**Znj.Doruntina Zenelaj**

**Z.Alban Berisha**

**Z. Bexhet Kuçi**

**Z. Reshat Selimaj**

**Z. Lirim Qatani**

**Z. Aziz Bytyqi**

**Znj.Sanie Kuçi-**

**Rexhepaj**

**Znj.Fidaije Kukaj**

**Znj. Afërdita Morina**

**Z. Vullnet Luzhnica**

**Z. Xhevshet Gashi**

**Z.Edon Sadikaj**

**Znj.Saranda**

**Bajraktari**

**Znj.Mimoza Bajraktari**

**Znj.Festë Kabashi**

**Z.Dardan Berisha**

**Z.Bajram Basha**

**Znj.Mevlude Kabashi**

**Znj.Sheqerije Zyrapi**

**Znj.Laureta Tafaj**

**Z.Liridon Fandaj**

**Z.Qëndrim Elshani**

**Z.Herolind Limaj**

**Znj.Jehona Rrafshi**

**Të pranishëm të tjerë**

**Kryetari i Komunës**

**Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

## **REND DITE**

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56,të datës15.03.2007;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2022 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-14453;**
- 7. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2023 të Komunës së Suharekës;**
- 8. Shqyrtimi i peticionit;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Urim Suka** - në emër të grupit të LDK-së kemi një kërkesë të cilën e kemi parashtrur edhe në KPF, madje e kemi marrë edhe zotimin e juaj që nëse kalon kjo pikë, do të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës. Kërkoj mirëkuptimin tuaj si Kryesues dhe të gjithëve që pika e shqyrtimit të peticionit mu trajtu me prioritet si pikë e parë për shkak se është më e veçantë se pikat tjera dhe për shkak se është kërkesë e qytetarëve.

**Kryesuesi** - unë besoj që çdo pikë që vie në Asamble për trajtim e kanë një karakter të veçantë dhe renditja nuk qon peshë. Unë e hedh në votim propozimin e shefit të grupit parlamentar të LDK-së, që pika e 8-të diskutohet si pikë e parë.

**9 për,14 kundër,4 apstenime  
Nuk kalon kërkesa**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**21 për,9 apstenime  
Miratohet rendi i ditës**

### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Selman Kolgeci** - ka pas vërejtje disa herë me procesverbalin dhe mendoj që secila fjalë që flasim dhe secili debat i anëtarëve të Kuvendit është i rëndësishëm dhe duhet të pasqyrohet në procesverbal. Është mirë të sigurohet një lloptop për procesmbajtësen.

**Kryesuesi** - është e vërtetë që ne kemi diskutu edhe në të kaluarën dhe është pak e vështirë mbajtja e procesverbaleve por edhe unë kam një kërkesë nga ju. Kur ta keni ndonjë fjalim më të gjatë dhe e keni të përgaditur, është mirë t'ia jepni një kopje të materialit që ta ketë më të lehtë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1 me vërejtjet që u dhanë.

## 28 për, 2 kundër Miratohet pika 1

### **Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56, të datës 15.03.2007;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Laureta Tafaj** - pse nuk po mundeni me i mbrojtë dhe çka do të bëni tash?

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës ka qenë dy herë në Komunën tonë dhe ka monitoru monumentet e vlerave natyrore të cilat kanë qenë nën mbrojtjen e Komunës me vendim të Kuvendit të Komunës dhe ata në bazë të dy raporteve që i kanë prezantuar në Komunë kanë konstatuar që dy trungje dhe burimi i ujit në Reqan e kanë humb vlerën dhe kërkojnë që të hiqen nga projekt-vendimi. Gjithëashtu kanë konstatuar që tri trungje tjera në Komunën e Suharekës i plotësojnë kushtet dhe kriteret në bazë të ligjit të natyrës që të futen në zonat e mbrojtjes. Nëse nuk gabohem, trungu në Reqan dhe Greikoc janë dëmtu nga faktori njeri dhe për atë arsye kanë kërku që të hiqen nga zona e mbrojtur.

**Laureta Tafaj** - pikërisht që pretendohet që është dëmtu nga faktori njeri, a ka qenë në mbrojtje? Si mundet me u dëmtu një gjë që është në mbrojtje?

**Kryetari** - nuk është kompetencë e Komunës me i ruajt. Ne i kemi obligim ato që vijnë me i fut në sistem dhe kjo ka ardhë prej Prishtinës dhe ne e kemi obligim me i sjell në Asamble Komunale.

**Laureta Tafaj** - për deri sa pe sjellim në Asamble dhe po e marrim vendimin, a nuk është e jona? A nuk po na takon neve?

**Kryetari** - jo, ky vendim do të shkoj edhe një here dhe do të shikohet ligjshmëria. Rastin konkret e kemi një listë në Suharekë dhe ai është listë i Tomës dhe nuk është i Tomicës.

**Urim Suka** - Kryetari shpeshherë kur ka me marrë merita, merr merita për ato që vijnë prej ministrisë dhe tash kur duhet me ik prej përgjegjësive, ik prej përgjegjësive. Për deri sa na vje me votu, i kemi përgjegjësitë si Komunë. Çdo aset që është i Komunës është përgjegjësi e jona dhe nuk duhet me i ik përgjegjësive por duhet me i marrë përgjegjësitë. Edhe ti si Kryetar, edhe ne si asambleist dhe drejtorive tuaja si drejtori dhe në këtë rast drejtoria e kultures, mendoj që është pak a shumë përgjegjëse për me trajtu këtë çështje. Fillimisht ne jemi për me kalu pjesën e këtij projekt-vendimi por atë që dua të them dhe që e kam thënë edhe në KPF për me funksionu edhe në të ardhmen. Në qoftëse ne e kemi pas një vendim për mbrojtje dhe këto asete që kanë qenë të mbrojtura janë dëmtu dhe ajo që është konstatu është që janë dëmtu nga faktori njeri, dikush duhet ta bëjë një raport, një vlerësim se kush e ka bërë dëmin dhe duhet mu denu ndoshta dikush. Një trung që ka qenë në mbrojtje të shtetit është dëmtu. Cila është logjika, kur ne po i fusim këto në mbrojtje dhe në fakt nuk kemi qenë në gjendje me i mbrojtë. Unë lus Komunën për përgjegjësinë që i takon dhe nëse nuk e ka kompetencë, le ta infomon atë që e ka kompetencë. Kanë qenë disa ide edhe në KPF që nëse është fut diçka në mbrojtje, duhet të vendoset një pllakë ose diçka tjetër në mënyrë që të dihet diçka që është në mbrojtje.

**Dardan Berisha** - në parim jemi pro këtij vendimi por kam një kërkesë për Drejtorin e Shërbimeve Publike që në qershor kur të bëhet rishikimi i buxhetit, le ti fut në projekte kapitale vendosjen e rrethojave në afërsi të këtyre monumenteve dhe vendosjen e tabelave që tregojnë që këto monumente janë në mbrojtje.

**Liridon Fandaj** - është hera e pestë që Kryetari mundohet të thotë që një subjekt politikë ka nostalgji për shkollat e vjetra të atij sistemi. Unë dua ta pyes Kryetarin: ku e ka të kryer shkollën?

**Kryetari** - në Beograd dhe mburrem ku e kam kryer. Por dallimi mes meje dhe teje është është shumë i madh. Unë kam shku, e kam mësu gjuhën, kulturën dhe vetëdijën dhe ja kam thy pushkën, ndërsa ti nuk ke bërë asgjë për këtë vend.

**Liridon Fandaj** - për pushkë e di sepse të mbaj mend edhe në luftë se sa ke qenë trim dhe sa ke luftu.

**Visar Kuçi** - kjo ka të bëjë me ambientin dhe ambienti është si sektor te Drejtoria e Shërbimeve Publike.Këto objekte natyrore menaxhohen prej departamentit të trashëgimisë kulturore.Nuk do të thotë që është dëmtu prej dorës së njeriut dhe ka me heq nga lista por këto objekte janë trungje dhe mundet edhe me u tha.Ky departament i kontrollon dhe i ka edhe në koordinata dhe sa e di kohë pas kohe i vizitojnë.P.sh. trangu në Osoja në 2018 ka hy dhe ne e kemi edhe në hartë zonale por në sistem tek ata nuk ka hy. Sa e di trangu në Reqan është dëmtu në vitin 2015,e ka dëmtu një qytetarë dhe janë marrë organet me atë çështje.Edhe ne, edhe qytetarët jemi të obliguar me i mbrojtë ose me njoftu autoritetin. Sa i përket trungjeve në Krushicë dhe Blacë,ne nuk i kemi në hartë zonale.Ata kanë kërku që të hyjnë në sistem dhe ne e kemi përgadit dokumentacionin,i kemi rregullu,i kemi gjet koordinatat dhe besoj pas një kohe do të futen edhe në harta zonale.Pjesa që janë në mbrojtje,i kanë tabelat.Nuk mundemi me i rrethu sepse kryesisht janë në prona private.Pasi të hynë në sistem do të kujdesemi që ti vendosim tabelat sepse është përgjegjësi e Komunës.

**Vullnet Luzhnica** - rreth kësaj pike unë kam dy pika të cilat përfshihen edhe në plotësim-ndryshim, pikat për Luzhnicë të cilat janë:Guri i gjamisë ku statuti i pronës i përket agjensionit të pyjeve dhe trungjet e bungut ku statuti i pronës është pronë komunale.Unë e kam rishiku vendimin nga 2007-ta e tash dhe nuk i ka ende të parcelizune këto 5 ari që po flasim.Kisha kërku që ta bëjmë këtë plotësim-ndryshim edhe te këto dy pika dhe sidomos kjo që është te agjensioni i pyjeve dhe të përcaktohen se ku janë këto 5 ari.Është mire të specifikohet dhe të vendosen rrethoja ose një pllakat që specifikon ku informon që është në mbrojtje kjo pjesë.

**Kryesuesi** - po kërkon vetëm me ia vendos nga një pllakatë.

**Vullnet Luzhnica** - trungjet e bungut është mbi 3 hektar dhe ajo që kërkoj është që nëse janë 5 ari,të specifikohen ku janë ato 5 ari në këtë 3 hektarësh dhe statute i pronës te guri i xhamisë me kompetencë është me agjension të pyjeve.Ajo që dua ta dijë është që në 199 hektar,ku janë ato 5 ari?

**Visar Kuçi** - nuk do të thotë që çdo herë ka për ti pas 5 ari mbrojtje përrreth objektit që është i përcaktuar.Mund të jenë edhe më shumë trungje.Objektet në mbrojtje aty ku janë,nuk qon peshë për ne prona.Ne interesohemi,ose ti bën kërkesë ose ne dhe i fusim në listë.

**Kryesuesi** - këto janë në listë dhe po kërkon me i lokalizu.

**Vullnet Luzhnica** - edhe një here jep sqarime sa i përket kërkesës rreth kësaj pike.

**Avni Bytyqi** - raporti i institutit thotë që trungjet në Luzhnicë si dhe guri i xhamisë në Luzhnicë janë në gjendje të mire dhe thotë që nuk i kanë tabelat informuese.Drejtori u zotu që do të bëhen tabelat informuese në të gjitha vendet ku janë të mbrojtura nga natyra.Sa i përket çështjes së kufizimit të zonës,ata me vet faktin që i kanë përkufizua trungjet,le të kuptohet që përgjegjësia e të gjitha trungjeve që janë,nuk guxon të preket nga askush sepse janë në mbrojtje të sipërfaqes.Çështja e 5 ari që është propozu te trungjet është kërkesë e ministrisë për arsye se,nëse afrohet dikush afër nuk guxon të gërmoj rreth trungjeve sepse mund t'ia dëmtoj rrënjët e pastaj të ketë pasoja.

**Vullnet Luzhnica** - ajo që ne kërkojmë,është që të ruhet si parcelë sepse është ruajt me gjenerata të tëra.

**Selman Kolgeci** - te neni 1.1 i këtij projekt-vendimi i kanë cek disa monumente që duhet me i largu për shkak se janë dëmtu por ne nuk morëm një përgjigje prej kujt janë dëmtu.A janë dëmtu prej dorës së njeriut?A janë dëmtu prej një force madhore siq është:uji,zjarri etj?Çështja tjetër, ju keni referuar Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor dhe mendoj që e keni lëshu një gabim teknik për shkak se kjo ministri ka vite të tëra që është fuzioni bashkë me ministrinë e Infrastrukturës.Çështja tjetër, keni thënë që ky vendim hynë në fuqi në vitin 2007 dhe e nënshkruan Sali Asllanaj,Kryetar i Kuvendit.A është gabim teknik?

**Avni Bytyqi** - vendimin e vitit 2007 ju kam dërguar si dokument se çka po ndryshohet.Duhet ta shikosh te plotësim-ndryshimi.Burimi i ujit në Reqan është konstatu që vetvetiu e ka humb vlerën për të qenë në mbrojtje të natyrës ndërsa dy tjerat janë konstatu që janë dëmtu nga faktori njeri.

**Flamur Bytyqi** - ky diskutim që u bë më duket më shumë si çështje teknike por vlera më e madhe është që ne si Komunë i kemi hup ato vlera të trashëgimisë kulturore.Pra, ne si Komunë nuk kemi bë asgjë për mi mbrojtë ato vlera.Drejtoria e Kulturës është dasht ta bëjëjë publike një listë të cilat janë të mbrojtura,me i pa edhe qytetarët dhe nuk e kemi një gjë të tillë.Unë besoj që Komuna është dasht të lexoj libra që njerëzit i kanë shkru për Komunën tonë,për trashëgiminë e kulturës në Suharekë dhe besoj që

Drejtoria e Urbanizimit nuk është dashtë me lëshu leje për disa vende që i ka lëshu ku ka trashëgimi kulturore.P.sh. në Semetisht që ka dhe askush nuk është marrë me atë punë.

**Lorika Gashi** - trashëgimi kulturore është një trashëgimi që është një monument ose gjetje arkeologjike kurse kjo i takon mbrojtjes,mjedisit dhe ambientit,prandaj nuk ka ardhë kërkesa te unë.Sa i përket listës për trashëgimi kulturore,është në Ministri të Kulturës dhe është listë zyrtare.Ka qendra për trashëgimi kulturore rajonale dhe ne i takojmë qendrës së Prizrenit dhe ata janë kompetent për gjithëçka,për apdetimin e listës sepse çdo vit apdetohet ajo listë.Ka mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme.Edhe ne e kemi atë listë dhe ne e bëjmë kërkesën nëse e shohim të arsyeshme në duhet me u heq ose me u fut diçka në mbrojt por jo ne me marrë vendimin.

**Flamur Bytyqi** - kjo nuk është për mua por është për qytetarët dhe zhvillimin e turizmit në Suharekë dhe ju ia keni humb vlerat.

**Lorika Gashi** - qytetarë jemi të gjithë.

**Flamur Bytyqi** - ti nuk bën kërkesë.

**Lorika Gashi** - unë thashë që mund të bëjmë kërkesë por nuk mund të marrë vendim.

**Flamur Bytyqi** - ti po thua që ta marrë në ministri.Pse mos me pas Komuna?

**Lorika Gashi** - e kemi,është publike në ministri.

**Visar Kuçi** – Flamur, nëse mundesh sqaroma lejen e ndërtimit që e përmende në Semetisht.

**Flamur Bytyqi** - lexoi librat që i kanë shkru për një vend në Semetisht që s'është marrë askush dhe në atë lokacion janë ndërtu shtëpi.

**Visar Kuçi** - ku është ai vend saktësisht?

**Flamur Bytyqi** - në Semetisht,te ish shkolla vjetër.

**Visar Kuçi** - a është pronë publike apo pronë private?

**Flamur Bytyqi** - një pjesë është prone private dhe një pjesë prone publike sepse ka qenë shkolla dhe ka artefakte të gjetura.Ska rëndësi a është private apo publike,e rëndësishme është të ruhet vlera.

**Visar Kuçi** - sa i përket zonave të arkeologjisë,të gjitha janë në sistem dhe janë publike.Nuk e di saktë a është kjo pjesë e Semetishtit por do të interesohem dhe do ta kthej përgjigjen.

**Reshat Selimaj** - nëse janë lisat te varrezat për të cilat po flitet,këto aksidentalisht janë djeg gjatë pastrimit,ku i kemi krumbullu ato që janë pastru,janë ndezë dhe janë tha.Pra janë dëmtu nga faktori njeri.

**Laureta Tafaj** - e din shumë mire ku janë dhe si janë.Në këtë vend s'po mund të mbrojmë as pyje,as fusha,bile as asfaltin që jeni duke e shtru vet.

**Flamur Bytyqi** - drejtoresha tha që janë publike.A janë në faqe të Komunës këto artefakte?

**Lorika Gashi** - e ceka dhe ekzistojnë në faqe të Komunës.

**Jehona Rrafshi** - gjatë eliminimit të trungjeve,dua të shpreh edhe një shqetësimin të lagjes së Bajraktarëve në Suharekë,ku afër rrugës kryesore është një lis rreth 25 m largësi.Duke pas parasysh disa rreziqe që mund të shkaktohen,si: rënia e lisit,mungesa e oksigjenit,mungesa që shkaktohet nga fobia e largësisë, ju sugjeroj që ta keni parasysh këtë shqetësim të qytetarëve.

**Bulëza Kuçi** - Drejtori tha që nëse gjeni ndonjë gabim teknik atëherë mund të na sugjeroni që ti përmirësojmë.Unë ia kisha rikujtu vendimin e vitit 2007 për mbrojtjen e vlerave të natyrës e cila është nënshkru nga ish kryetari Sali Asllanaj.Këtë projekt-vendim e kemi më të kompletuar sepse janë me koordinata e të gjitha ndërsa ju e keni sjell pa koordinata.Kjo tregon që qeverisje e LDK-së kanë punu më mire se sa qeverisjet e juaja.

**Avni Bytyqi** - në fillim vendimi ka shku në KPF pa koordinata dhe kërkesa ka qenë e antëtarës së Asamblesë Sanie Kuçi Rexhepaj,që projekti të përgaditet me koordinata sikurse vendimin i vitit 2007.Paraprakisht ju kamë dërguar materialin si ka qenë vendimin në KPF dhe ditën e nesërme e kam korigjuar dhe përmirësuar projekt-vendimin dhe ju kamë dërguar projekt-vendimin në emaile.

**Alban Berisha** - këta drunjë që janë në mbrojtje,përveq që e kanë një histori për shkak të vjetërsisë,qëllimi i tyre ka qenë që edhe kur janë mbjell në atë kohë,dikush e ka nis historinë me një qëllim që ka qenë ekologjia.Pavarësisht që nuk janë të mbrojtura,çka ka ndodhë me disa drunjë që kanë qenë të mbjellura në shesh dhe që plani ka qenë me u rikthy ato?Nuk janë rikthy por është shumë betonizim.A keni ndonjë plan me bë historinë dhe jo vetëm me folë për historinë,çka u mbjell dikur dhe si ta ruajmë.

**Kryesuesi** - faktikisht jemi në pikë për ti mbrojtë ato që i kemi.

**Alban Berisha** - unë po flas për ato që kanë qenë në shesh dhe që kanë qenë zotim i pushtetit,që kanë me u rikthy.Quhet qyteti i luleve por për cilat lule po flasim dhe për cilin gjelbrim?Çka ka me ndodhë me këta drunjë që ka qenë premtimi me i rikthy në shesh?

**Kryesuesi** - kemi mbjell më të buukra,janë duke u rritë dhe janë të mbjellur rreth 70 drunjë që janë mbjell në shesh.

**Visar Kuçi** - sa i përket trungjeve në mbrojtje natyrore,nuk hyn çdo trung sepse e ka një kriter dhe sa e di këto trungje janë 100 vjeqare e më shumë.Për pjesën e sheshit nuk e di çka ka ndodhë por të jesh i bindur që këta drunjë që janë vendos janë më me cilësi se sa ata që kanë qenë në t'kaluarën.Edhe këta,nëse ne nuk i mbrojmë ato veq kanë filluar të lakohen dhe është në pyetje që ne ti mbrojmë.Te rruga Avdyl Rama i kemi drunjët e vjetër dhe s'do të thotë që janë drunjë të vjetër dhe ne mos ti heqim.Janë laku dhe nuk janë mirëmbajtë.

**Alban Berisha** - mos thuaj që nuk janë mirëmbajtë mirë por thuaj që nuk jemi duke i mirëmbajtë mirë.

**Visar Kuçi** - nuk po ia jap përgjegjësinë një njeriu por institucionit.

**Kushtrim Kuçi** - në seancën e parë që është mbajtë këtë mandate,kam dalë me fotografi për sheshin dhe kamë kërku që secila pemë me i pas rrethojat sepse makinat kur po ecin mbrapa po i lakojnë.Shqetësuese është që nuk po jemi në gjendje me i mirëmbajtë, por ti mirëmbajmë këto që i kemi dhe sidomos pjesës së sheshit.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2 duke marrë parasysh që të vendosen edhe pllakat me mbishkrimin që është në mbrojtje me ligj.

**25 për,3 kundër,  
Miratohet pika 2**

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2022 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - në bazë të pasqyrave financiare të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusave” shihet qartë që në vitin 2022 NPL “Stacioni i Autobusave”është me një fitim solid në vlerën prej 4468 euro.Duke marrë për bazë vitet e kaluara të cilat kanë qenë me humbje,ky vit po shihet se është në fitim.Na shqetëson fakti që të hyrat nuk janë në nivelin e kënaqshëm pasi që bazuar prej vitit 2021 në vitin 2022 janë rritur të hyrat për 1128 euro.Në bazë të kërkesës zyrtare të vitit të kaluar NPL”Stacioni i autobusave” na ka ofruar tri kontrata të qiradhënies ndaj tre operatorëve.Nëse i marrim kontratat dhe vlerën e qerasë,na del që të hyrat nga qeraja duhet të jenë në vlerën prej 9600 eurove.Andaj kërkoj sqarim se a janë ndryshuar këto kontrata me këta operatorë dhe a është lidhë ndonjë kontratë me ndonjë operatorë tjetër pasi që edhe gjendja faktike tregon se ka më shumë operatorë se sa na janë ofruar neve si qiramarrës.Kush e shfrytëzon dhe kush po fshihet pas tyre?Shqetësuese është edhe fakti që stacioni i autobusave është NPL që operaon ilegalisht në një prone që asnjëherë nuk është shëndrruar në prone komunale nga ministria përkatëse dhe gjithëashtu ndërmarrja publike lokale nuk është e licencuar.Kërkoj sqarim se pse nuk është bërë bartja e pronës pasi që ekziston një vendim që kjo prone i është dhuru Komunës së Suharekës.

**Reshat Selimaj** - është e vërtetë që planifikimi jonë qalon nga pandemia e këndeje. Ne si ndërmarrje publike i kemi të regjistruara 144 linja urbane.Linjat urbane Suharekë -fshatra janë 22.18 i mbajnë here pas here kurse 4 janë shu.Nga këto linja rreth 35 % në mungesë të zgjidhjes së pronës,që ne jemi pa licencë dhe nuk kemi bazë ti qojmë në gjykatë se humbim dhe në mungesë të inspektorëve ato ndalojnë herë pas here para apo pas stacionit.Si komision i aksionerëve ne kemi kërku dhe kemi vendos një shenjë ndaluese në mënyrë që autobusat mos të ikin mbrapa dhe ajo shenjë është heq,kurse linjat Suharekë-Prizren dhe anasjelltas janë 13 dhe këtu dy janë të shuara.Linjat Suharekë-Malishevë janë 4,linjat Suharekë-Prishtinë dhe anasjelltas janë 20,ku edhe këta nuk e shfrytëzojnë.Në momentin që unë kontaktoj me inspektor dhe atë ditë që dalin,ndryshon raporti i të hyrave për mire.Si kompani ne kemi telashe në planifikim për dy çështje që i kemi ngritë në vazhdimësi dhe problem është prona.Do ti drejtohem edhe kësaj radhe Drejtorisë për Katastër dhe unë do ti ndjekim rrugët ligjore sepse kemi shku në Prishtinë në

organet kompetente për pronë dhe ata kanë thënë që nga 2013-ta prona i ka kalu Komunës. Kërkesat tona rrinë nëpër sirtare të Komunës dhe ata persona do të japin llogari. Ndërmarrja ka dy qera, nga 75 euro dhe një restotant që paguan 650 euro në muaj dhe biletat. Në vitin 2007 ndërmarrjes iu kanë marrë 6 lokale që kanë pas vlerën minimale 50 euro deri 75 dhe i kanë bartë në menaxhim të K. Komunal dhe qeraja min. është 9.5 dhe max. është 25. Unë kërkoj nga të gjithë të japim kontribut dhe ta zgjidhim statusin e pronës sepse unë vitin tjetër nuk mund ti mbuloj as rrogat.

**Qëndrim Elshani** - këto kontrata a janë shëput?

**Reshat Selimaj** - po janë shkëput sepse u ka skaduar mandati. Ne në stacionin e autobusave kemi pas dy konkurse ku janë zhvilluar të gjitha procedurat. Konkursin e dytë, me vetëdëshirë anëtar i bordit z. Naim Kicaj jep dorëheqje dhe kam shpallur konkursin e dytë. Kemi bërë përzgjedhjen në bazë të kompetencave ligjore dhe anëtarë konkurentë kanë pas ankesë. Rasti është në agjension dhe çka do që vje nga agjencioni, ne marrim masa. Kemi pas shumë telashe dhe mendoj që duhet të formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave nga Asambleja.

**Selman Kolgeci** - po thoni që ka pas iniciativa për licencimin e stacionit por kërkesat kanë has në vesh të shurdhër duke përfunduar në sirtar. Ku i keni bërë këto kërkesa, te kush dhe kush është prolongu në këtë proces? Sa kanë qenë pritjet për fitime në stacion në fund të vitit 2022? Sa janë humbjet nga mos përgjigjja e operatorëve të transportit, gjegjësisht nga ikja e pagesës së peronizimit? A keni evidence se cilët janë operatorët e papërgjegjshëm të cilët nuk po paguajnë peronizim? A keni strategji se si ta evitoni këtë dukuri negative që po e shkatërron stacionin e autobusave vit për vit? A keni qenë në harmonizim me Komunën kur është vendos dhe kur është heq tabela informuese? A ka shkaktuar humbje largimi i asaj tabele dhe sa janë humbjet? Dikush duhet të jap përgjegjësi për largimin e asaj tabele sepse unë kam bërë kërkesë për vendosjen e asaj tabele por edhe pse kemi marrë premtim nuk është vendosur. Një pjesë të fajit ia kanë drejtuar Asamblesë. Cila ka qenë kërkesa të cilës nuk iu ka përgjigjur Asambleja? Me çfarë motivi po i lejoni automjetet private që të futen brenda stacionit? Kam qenë i informuar se ka pas një aksident automjet-autobus brenda stacionit. Kisha një pyetje për disa pagesa të disa anëtarëve të bordit të cilëve iu kishte skaduar mandati. A kanë gjetur mbështetje ligjore? Kryesues, ju na keni thënë që është jashtë ligjore. Lidhur me konkursin, Reshati tha që është në agjencinë kundër korrupsionit dhe nuk pranoj me dhënë informacione më shumë. Pse për një rekrutim kaq të thjeshtë duhet me pas komplikime kaq të mëdha? A ka pas ndërhyrje në atë konkurs?

**Kryesuesi** - ndërmarrja deri në kohën e pandemisë ka funksionuar shumë mire pa marrë parasysh problemin me pronën që e cekti dhe Reshati, që në atë kohë kam qenë unë, Lule Bralio dhe Murtez Zekolli. Ne kemi bërë përpjekje me këto pronë sepse është legjitime. Është një dokument që është dhuruar ajo nga agjencioni i pyetjeve për Komunën. Problemi ka filluar në stacion prej kohës së pandemisë mirëpo nuk është keq sepse është ndërmarrja e vetme në Kosovë që nuk ka asnjë obligim ndaj shtetit, as Komunës. Unë jam i pajtimit që këto probleme që u shfaqën, ne duhet ti rregullojmë.

**Reshat Selimaj** - Selman, kërkesën në vitin 2014 e tutje e ka pas në shqyrtim z. Sylejman Hoxha Drejtor i Katastrit dhe në takimin që e kam pas me gjithë ata akterë përgjegjës, çështja ishte 99 % gati dhe nuk është kryer. Në vitin 2017 kur vijmë ne në pushtet, vje drejtor Emrush Bytyqi dhe prap nuk është kryer. Do ti drejtohem z. Armend Krasniqi. Sa i përket humbjeve, kemi rreth 35 % humbje nga mos puna e inspektorëve dhe pengesa e liqencës. Sa i përket tabelës, në momentin kur është hequr tabela ka për 25 % rënie të të hyrave. Kërkoj që të vendoset ajo tabelë.

**Kryesuesi** - dua të plotësoj te pjesa e licencimit. Deri në vitin 2017 licenca jepet çdo 5 vite dhe është vazhduar por njëri prej kriterëve nuk ka qenë konkretisht që stacioni i autobusave ta ketë pronën e vet por me ndërrimin e gjërave po e kërkojnë dhe kjo po e pengon stacionin e autobusave që nuk po mund ta marrë licencën.

**Reshat Selimaj** - është mire ta falemderojmë inspektorin republikan z. Samir Fusha i cili e din dhe unë me përgjegjësi të plotë flas që në nivel të Kosovës është stacioni më pozitiv me bilanc.

**Xhevdet Gashi** - kam shkuar në Prishtinë në agjencionin e pylltarisë dhe ata na kanë njoftuar që i ka kalu agjencionit për privatizim. Kemi kontaktuar edhe me agjencionin për privatizim dhe ata thënë që toka ka kalu në pronë komunale. Unë kam kontaktuar me Nexhat Elshanin dhe me Sali Gashin. Është punë në atë drejtim por janë në sirtarin e Drejtorisë së Pronës. Ne do ta bëjmë një kërkesë te ata dhe për të ardhmen ne duhet me marrë një model të Prizrenit se si ka kalu toka në pronë të stacionit të autobusave.

**Selman Kolgeci** - nuk mi dhe të gjitha përgjigjet dhe nëse nuk mund të përgjigjesh, mund ti dërgoj edhe me email. Pyetjet ishin se a ka strategji se si keni me evitu dukurinë e ikjes së autobusave prej pagesës së peronizimit, çështja e automjeteve që po futen brenda stacionit dhe çështja e pagesave të anëtarëve të bordit. Kryesues, the që është mirë një fitim i vogël. Nuk mendoj që duhet me u krenu që një ndërmarrje e tillë po ja arrinë me mbajtë veten. Reshati përmendi që kemi 35 % humbje nga mos licencimi dhe po thotë që i kemi në sirtar. Tha në 2014 dhe ne sot jem në 2022-tën dhe jemi 9 vite diferencë. Çka kemi bërë për 9 vite? 25 % ulje të të hyrave ditore prej largimit të tabelës. Kush duhet të jape përgjegjësi për këtë?

Reshat, ti e din që është vepër penale nëse nuk e kryen detyrën zyrtare një zyrtar i Komunës dhe në këtë rast inspektori. Nëse ka një dëshmi të tillë, hajde ta qojmë ku duhet. Te çështja e licencimit, kjo është pasoja që ne ju kemi propozu edhe emrin tonë për anëtar të bordit por keni dasht ta bëni tuajin.

**Reshat Selimaj** - në strategji ne e kemi bërë një propozim por nuk kemi mujt me shty përpara për shkak se janë në krizë edhe kompanitë. P.sh. kompania që operon në Greikoc, 80% e udhëtarëve nuk udhëtojnë me atë kompani sepse gravitojnë me makina. Ne kemi bërë strategji që sa linja janë, me inkasu blanko. Por ku i marrin ato, sepse edhe ata janë në krizë. Reshat Selimaj tregon faturat e vitit 2007 të paguara për trafika. Kur i kanë marrë këto trafika, këto janë marrë me paramendim. I kanë marrë 6 dhe ia kanë lënë 2 dhe një restorant dhe penorizimin e kanë bërë vetëm sa me mbijetu dhe jo me zhvillu. Kur i kanë marrë ata zyrtar, në 2007-tën u desh me i marrë krejt. Pse i kanë lënë dy? Me këto fakte unë do t'i drejtohem edhe organeve kompetente.

**Selman Kolgeci** - ti je anëtar i bordit dhe asnjë përgjigje nuk e dhe si duhet. Kush është fajtor që stacioni i autobusave i ka pas 25 % humbje ditore për një tabelë që e keni heq.

**Kryesuesi** - pikërisht qëndron problemi te licenca. Në moment kur ta ka licencën, inspektori republikan Sami Fusha e qon në gjykatë dhe paguan 200 euro një gjobë. Ne duhet të bëjmë përpjekje ta licencojmë stacionin e autobusave dhe në moment kur ta merr pronën, të gjitha problemet zgjidhen.

**Reshat Selimaj** - unë do ti ndjek procedurat ligjore dhe ai që i ka bërë këto skenare ka me dhënë llogari, edhe ata drejtorë që ju kam drejtuar me shkresa dhe s'kanë dhënë përgjigje.

**Urim Suka** - ajo që unë dua të them është se ne sot diskutuam për gjithë historinë e stacionit por në fakt rendi i ditës është për të diskutuar raportin e vitit 2022. Kur e dëgjova fjalën e Reshatit, fillova me kuptu që jo i gjithë faji është te Reshati dhe te komisioni ndoshta. Faj këtu ka edhe pjesë tjera që nuk paskan funksionu edhe hallkat mes komunikive që i keni bërë mes vete ju si pushtet. Unë po mendoj dhe ashtu po del, si kemi fol edhe atëherë kur është formu ky komision. Synimi juaj ka qenë që ju këtë komision me kthi prej një komisioni që është ndërmarrje publike dhe ju keni dasht këtë ndërmarrje me bërë ndërmarrje të koalicionit. Te pjesa e të hyrave, a janë 4000 më pak apo 2000 më pak apo më shumë, nuk është dëmi shumë i madhë kur problem është te menaxhimi. U fol te peronizimi dhe është shumë e thejshme. Janë dy çështje: ose kompanitë e kanë të pamundshme me përballu atë tarif dhe nëse është e madhe ajo tarifë, hajde të ia ulim tarifën. Nëse ajo tarifë nuk është e madhe, keni inspektorët, dhe ata le ta kryejnë punën e vet, ta denojë atë që ndalet te dera për shkak se e rrezikon edhe qytetarin. Në këtë raport shkruan që një drejtor ka dhënë dorëheqje dhe kësaj nuk i vje një erë e mire nëse dikush jep dorëheqje. Në mungesë të korumit bordi i drejtorëve, ju si komision keni marrë vendim me vazhdu mandatin e kryeshefit ekzekutiv dhe as kjo nuk është një veprim që duhet mi ndodhë kësaj kompanie por duhet me ekzistu korumi dhe me u vazhdu mandati sipas asaj që duhet. Keni shpall një here dy konkurse publike për dy pozita të drejtorëve të bordit dhe pas dorëheqjes e keni shpall edhe një konkurs tjetër. Ju vet në këtë raport shkruani që këto konkurse kanë përfundu në agjencinë antikorrupsion në Prishtinë dhe këto konkurse kanë mbet pezull. Çka doni ti thoni kësaj për deri sa ka përfundu atje? Fakti që ka përfundu atje, po flet vet, po vërteton dyshimet tona kur ju e keni themelmu komisionin njëanshëm. Ju keni vendos vet një vit më pare. Ju numrat i keni edhe sot sepse qytetarët ju kanë dhënë besimin por duhet ta dini një gjë: ju nuk e keni marrë besimin për këto veprime dhe këto vendime të njëanshme e të dëmshme që po merrni çdo ditë. Andaj ne jemi këtu për të adresu çdo veprim e vendim të dëmshëm që ju po merrni e për të dëshmu me fakte para atyre që votuan për ju. Kjo është çasja juaj, e vërteta juaj dhe këtë duhet ta dini të gjithë qytetarët. Sikur të dëgjoni fjalën tonë një vit më pare e të formoni një komision gjithëpërfshirës ndoshta sot nuk do ta kishim këtë rezultat por tani kjo është gjendja dhe kjo nuk është kjo, që ajo unë dua, Andaj ne votojmë kundër këtij raporti dhe



kërkojmë që komisioni që është votuar atëherë njëanshëm,duhet të shkarkohet dhe duhet të formohet një komision i ri.

**Reshat Selimaj** - të drejtën e ankesës askujt s'kam të drejtë me ia ndalu.Është kompania numër 1 në Kosovë që ka bilanc pozitiv.Sa për shkarkim,bëji votat dhe kur të duash shkarkom.

**Urim Suka** - vet i ngriti kritikën ndaj pushtetit dhe tash krejt barren po e merr dhe pe mbron.Po thotë që kemi punë me fitim dhe në anën tjetër vet e tha që mbi 35 % jemi në humbje.

**Reshat Selimaj** - të hyrat që i planifikojmë ne i llogarisim që këto linja hyn secila një nga një.Nuk ka ardhë agjencioni por pala që ka dërgu ankesë.

**Xhevdet Gashi** - problemet në stacion të autobusave janë që 22 vite por gradualisht po përmirësohen.Ka shku në agjencionin kundër korrupsion sepse kandidati ka bërë ankesë.Nuk them që ka qenë perfekt por në konkursin e dytë nuk ka pas asnjë kandidat.Kur janë bërë ankesat,nuk ka pas komision për ti shqyrtuar ankesat.Ne komisionin duhet ta formojmë këtu.

**Kushtrim Kuçi** - sot po e heqin tabelën dhe nuk jemi në gjendje ta ruajmë dhe është vërtetë shqetësuese.Të lus Reshat të mos merresh prej 2017-tës por merr tash e mbas.Filloji procedurat sepse na ke për krah dhe drejtoju drejtorisë përkatëse dhe gjej zgjidhje.

**Reshat Selimaj** - kërkoj të më ndihmoni si t'i kthejmë 6 trafikantët në menaxhim të pronës.Ne i menaxhojmë dhe paret i merr dikush tjetër.

**Kushtrim Kuçi** - e kam ngrit si shqetësim në Asamble që i vetmi objekt në Komunën e Suharekës që e ka ruajt arkitekturën komuniste dhe nuk bëhet asgjë është stacioni i autobusave.Kjo është shqetësuese dhe unë nuk po them që ti je fajtor ose kjo qeveri ose të gjitha qeveritë.I vetmi investim që u bë në stacion të autobusave ka qenë në kohën e LDK-së dhe sot kam pritë që stacioni i autobusave me pas krejt pamje tjetër,një fasadë strukturale tjetër.Ti lëm anash dhe të fillojmë të bëjmë diçka të bukur për të ardhmen.

**Reshat Selimaj** - jam mundu maksimalisht por është problem licencimi.

**Alban Berisha** - përveq si asamblesist,tani si qytetar i Komunës së Suharekës,ku jemi në ndeja private dhe kur dëgjohej një fjalë për korrupsion,normal që ndihem i shqetësuar dhe sidomos ne si përfaqësues të qytetarëve.Në organet tona të drejtësisë kemi çdo ditë që shkojnë njerëzit nëpër intervista para hetuesëve ku disa dalin fajtor e disa të pafajshëm dhe ky është sistemi i drejtësisë.Kolegët e mi e dine kur fillon një hetim ose një rast.Ajo mund të fillojë kur dy persona janë duke pirë kafe,që dikush ka keqpërdor diçka dhe zyrtarisht mund të niset një faze e procesit.Në një organ publik me transparencë dhe me transmetim live nëpër mjete të komunikimit,akuzohen inspektorët.Unë e mora si akuzë ndaj inspektorëve për keqpërdorim.

**Reshat Selimaj** - është thënë marrëveshje mes kompanive.

**Alban Berisha** - më herët the që e marrin informatën,komunikojnë në mes vete.Nëse e kam dëgju keq,kërkoj falje.Nëse ti e ke keqinterpretu është diçka tjetër.Çdo fjalim i kolegëve të mi që ishte, arsyetimi ishte mos puna e inspektorëve.Nëse nuk janë duke e kryer punën dhe këtu akuzohen,kjo është shumë shqetësuese.Unë nga parimi personal po e them që para se me akuzu dikënd për keqpërdorim, njëherë e deponoj një kallzim në polici e pastaj e akuzoj këtu.Ju kërkoj falje të gjithëve nëse unë e kamë marrë vesh keq por nëse është ashtu është shumë shqetësuese.

**Reshat Selimaj** - në momentin kur dalin inspektorët,kompanitë komunikojnë njëri me tjetrin.

**Selman Kolgeci** - ti u krekose me rezultatin pozitiv të tij dhe Reshati po krekoset që kemi dal 4000 euro fitim në stacion.S'ka nevojë për procedura dhe e lëmë stacionin pa licencim.Me këtë kapacitet që e ka ndërmarrja me sjell fitime,ne qëllimisht jemi duke mos i marrë këto të mira prej ndërmarrjes.A jemi duke shku duke e shkatërru atë ndërmarrje?Edhe mos veprimi denohet Reshat.Nëse ka mbet çështja e pronës me kalu çështje procedurale,pse ne duhet me diskutu kaq shumë?Hajde ta dërgojmë ku duhet.

**Reshat Selimaj** - unë e thashë që ne kemi shkresa që iu kemi drejtu organeve kompetente.Në asnjërin nuk ka me bërë dallim.Unë ka mi ndjek procedurat.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**16 për,12 kundër  
Miratohet pika 3**

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Selman Kolgeci** - unë kam një pyetje për zyrтарin ligjor sa i përket kësaj pike. E keni sjell një projekt-vendim për inicimin e planit rregullues për Duhël. Ka qenë Biraqi dhe e keni sjell Duhël. Ne e kemi aktiv një projekt-vendim të planit rregullues të hollësishëm për zonën ekonomike në Biraq. Bëhet fjalë për të njejtin lokacion, për të njejtën parcelë, me prejashtim që iu ka heq një parcelë tash. Unë nuk besoj që lejohen dy vendime për një çështje të njejtë. Nëse kemi plotësim-ndryshim të vendimit është diçka tjetër. Besoj që nuk jeni të përgaditur këtë seancë me kalu këtë vendim kur e kemi edhe një aktiv

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që kur është marrë muajin e kaluar vendimi, ka shkuar për shqyrtim të ligjshmërisë në ministri. MAPL-ja e ka kthyer në rishqyrtim me plotësim të shtimit të parcelës. Sa i përket emërimit është e vërtetë që në këtë rast drejtori sëbashku me mua kemi gabuar të çështja e emërimit në Biraq për arsye se ne në vitin 2001 e kemi një vendim që nga ky Kuvend është marrë dhe është themelua Zona ekonomike në Biraq mirëpo me hartën zonale që është miratuar vitin e kaluar është e miratuar çështja e zones ekonomike në këto parcela dhe emërtohet zona ekonomike Duhël. MAPL-ja kur ka hyrë në hartën zonale e ka konstatuar që zona ekonomike është planifikuar në Biraq por emërimit e ka Duhël dhe ka kërkuar të përmirësohet ashtu si është në hartë zonale. Të gjitha çështjet që janë të rregulluara me plan zhvillimor dhe me hartë zonale, fare nuk ka nevojë të merret vendim në këtë kuvend për me bë një veprim të tutje.

**Selman Kolgeci** - ne nuk e patëm vetëm çështjen e emërimit. Titulli, a do të shkojë plotësim-ndryshim apo vendim i ri?

**Avni Bytyqi** - Vendimet të cilat ne i kemi marrë muajin e kaluar nuk kanë mund të krijojnë efekt juridik për shkak se janë kthyer në rishqyrtim dhe tani ne jemi duke e bërë vetëm plotësim-ndryshimin e atyre kërkesave që kanë kërkuar ministria. Ky vendim tash e tutje merr fuqinë e ekzekutimit nëse e merr shqyrtimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja.

**Selman Kolgeci** - ne kur i kemi dhënë mbështetje në seancën e dytë të rregullt të viti 2023, ju kemi thënë që ju nuk keni ekspertizë të mirë në planifikime hapsinore, dhe tash po vërtetohet. Nëse nuk prodhon efekt juridik vendimi, pse na keni prurë vendimin për shujta me shfuqizim? Pse e keni prurë vendimin për Delloc me shfuqizim? Nëse në këtë projekt-vendim duhet me shënu plotësim-ndryshim i vendimit të kaluar, ta shënojmë ashtu sepse gabimet janë njerëzore.

**Avni Bytyqi** - në ligjin për vet qeverisje lokale Komunitat kanë për obligim që të gjitha vendimet që miratohen në Kuvend të dërgohen në ministrinë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë. Ministria konstaton a është e ligjshme apo jo. Nëse e kthen në rishqyrtim, ne e kemi për obligim ta rishqyrtojmë sipas kërkesave të ministrisë që ne aktualisht dy vendimet iu kemi referu kërkesave dhe rekomandimeve të MAPL-së ndërsa për vendimin për Dellocin, drejtorja e urbanizmit nuk ka mund ta përgadit për shkak se aty ka numër të parcelave të shumta dhe ka edhe prona private të cilat përfshihen në kuadër të planit rregullues të hollësishëm dhe aty duhet ndoshta të bëhet edhe një debat pak më i gjërë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci** - a ka kërkuar ministria me plotësim atë vendim?

**Avni Bytyqi** - vetëm nenin 1.

**Selman Kolgeci** - pse nuk po ia le emrin plotësim-ndryshim por projekt-vendim?

**Avni Bytyqi** - vendimi nuk mund të pësojë plotësim-ndryshim për deri sa nuk ka hyrë fuqi

**Laureta Tafaj** - nuk po i përsëris ato që tha Selmani sepse pothuaj ishin të njejtat, mirëpo Avni, the që nuk ka pas nevojë me prurë në Kuvend për me votu. Nëse është ashtu atëherë pse e ke prurë?

**Avni Bytyqi** - çështjet që janë të rregulluara tash me plan zhvillimor komunal e që i kemi miratuar në vitin 2021 dhe për hartën zonale 2022, nuk ka nevojë të merret më vendim në Kuvend sepse i ka rregulluar Harta Zonale. Çështja e vendimit të vitit 2001 që ne iu kemi referu si zonë ekonomike Biraq, kemi gabuar sepse ka qenë në hartë zona ekonomike Duhël dhe për ata ka kërkuar ministria që të referohemi hartës zonale.

**Urim Suka** - është paradoks një vendim për të njejtën çështje me prurë me shfuqizim, vendimin tjetër me lënë e me marrë një të ri. Nuk e di pse po këmbëngulni të një gabim që e kemi bë. Shqyrtimin që e ngriti Selmani janë thelbësore-tekniqe. Po dojmë me ndihmu procesin mos me lënë një vendim që u marrë në

kundërshtim.Hajde ta bëjmë plotësim-ndryshim sepse ashtu duhet.Ju po këmbëngulni por ajo është barrë e përgjegjësisë tuaj.

**Aziz Bytyqi** - është shumë e qartë për ata që janë jurist.Ai vendim nuk ekziston sepse nuk e ka marrë konfrimin nga ministria e linjës.Ata e kanë kthyer me vërejtje.Mos u thirr në atë vendim sepse nuk ekziston.Nuk mund të ndryshohet diçka që nuk ekziston.

**Urim Suka** - projekt-vendimi për Delloc,a ekziston?

**Aziz Bytyqi** - nëse nuk e ka marrë ligjshmërinë,jo.

**Urim Suka** - nuk e ka marrë dhe të njëjtën shkresë e ke për tri vendimet.Kjo e Dellocit e ka shkresën e njëjtë dhe vërejtjen e njejetë.Kjo e Dellocit ka ardhë me u shfuqizu ndërsa dy tjerat nuk po shfuqizohen sepse s'po prodhojnë efekt juridik.Pyetja ime është:Kjo e Dellocit a ka efekt juridik kur edhe ajo s'ka hy në fuqi?Pse e keni prur me shfuqizu?

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**15 për,10 kundër**

**Miratohet pika 4**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishtëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;**

**Kryesuesi** - elaboron këtë pikë dhe thotë që është e njëjta situatë me pikën 4.Hap debatin për pikën 5.

**Urim Suka** - është e njëjta situatë dhe ne vetëm për shkak të situatës që ju po doni me lënë barrë atë pjesën e vendimit,ne duhet me votu kundër sepse ju s'po doni me i përmirësu vërejtjet që ne dhamë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**15 për,10 kundër**

**Miratohet pika 5**

#### **Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-14453;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 6.

**23 për,2 apstenime**

**Miratohet pika 6**

#### **Pika 7. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2023 të Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Flamur Bytyqi** - te ky raport më duket që është një gabim dhe ju kisha lut që ta përmirësoni.Është te njëra prej faqeve ku shkruan:shpenzimet kapitale për periudhën janar-shtator 2020.Kjo i bie që si vlerë është komplet e gabueshme dhe unë mendoj që është mire të përmirësohet dhe me kthy.

**Labinot Halitjaha** - po e shoh që gjatë kohës që diskutuam,më shumë keni gjetë gabime teknike.Edhe kjo është një gabim teknik.

**Flamur Bytyqi** - nëse është gabim teknik,ju kisha lut ta përmirësoni dhe me na sjell prap.Çështja e dytë që dua të diskutoj është për shpenzimet te arsimit i mesëm në Suharekë.Janë afërsisht pagesa për vendime gjyqësore 203.000 euro ndërsa paga përmes listës së pagave janë 320.000 euro.A mund të na specifikosh drejtor i arsimit për këto pagesa për vendime gjyqësore.Sa shkojnë për taksa gjyqësore dhe sa shkojnë për mësimdhënës për shkak që ne e kemi vetëm si vlerë por nuk e kemi të specifikuar asnjëherë.

**Remzi Bajselmani** - nuk kam informata për këtë sepse nuk është n'domenin tonë dhe nuk merremi fare me këtë pagesë që bëhet.

**Flamur Bytyqi** - unë besoj që është dasht me u marrë sepse është në linjë buxhetore të arsimit dhe i ka marrë mjetet prej drejtorisë së arsimit dhe besoj që ti duhet me ditë se ku kanë shku këto mjete.Prej 203.000 eurove,cilat shkojnë për shujta dhe cilat për taksa gjyqësore?Ne kemi kërkun edhe një seancë të

kaluar që ta dimë se sa ju shkojnë për shujta që kanë pas të drejtë mësimdhënësit të marrin. Tani dua të di se sa shkojnë prej buxhetit të Komunës për përmbarues dhe për shpenzimet e gjykatës për shkak se rastet gati janë të njejta që po paditën. Ju po bëni dhe ankesë dhe dëmi më i madh kur ju po bëni ankesë është se po i shtohet edhe një vlerë tjetër .

**Remzi Bajselmani** - ne as nuk i planifikojmë, as nuk kemi linjë buxhetore në DKA për këto dhe as informata lidhur me to se si rrjedhin. Është çështje e qendrës. Ministria e Arsimit ka bunnxhet, ata kanë nënshkru kontratën dhe ata përgjigjen. Ne nuk kemi kompetencë.

**Flamur Bytyçi** - qeveria e Kosovës i ka nda 5 milion euro për shujta të nxënësve. Ku janë ato mjete në Komunë që nuk i marrin nxënës?

**Remzi Bajselmani** - për komunën tonë qeveria ka nda këtë vit 127.000 euro. Jemi në proces dhe kemi tendencë për të filluar ta realizojmë dhe ndodh që prej 1 majit mund të fillojmë. I kemi 120 ditë për ti realizu sepse buxheti është i vogël për ti realizur 3603 nxënës që janë 1 deri 5. Tani AQP ka një kontratë me Premium bkr dhe prej asaj ne duhet ti marrim sepse ne as nuk mundemi me I ble e as me I kontraktu.

**Flamur Bytyçi** - këto mjete a janë të alokuara për shujta sepse unë nuk i kam pa?

**Remzi Bajselmani** - janë në buxhetin e K. Suharekës të arsimit 127.000 euro.

**Doruntina Zenelaj** - nga sqarimi tekstual keni thënë se paga mesatare bruto e një të punësuarit në Komunë është 624.44 euro. Ju keni bërë një mesatare të thjeshtë dhe kjo nuk është mesatare ponderune që reflekton se nuk na jep një realitet. Pasqyrë jo reale e pagave mesatare të punësuarëve. Nga tabela e realizimit të të hyrave vetanake shihet se të ardhurat nga tatimi në prone në periudhën e njejtë të viti 2023 kanë ngritje nga viti 2022 por kanë rënie nga periudha e njejtë e viti 2021. Viti 2022 ka qenë viti ku ka qenë hera e pare që personat që kanë regjistruar automjetet, kanë pas të drejtë pa e pas edhe dëshminë e tatimit të pronës. Shqetësimi është se pse ende në vitin 2023 të hyrat për periudhën e njejtë krahasuar me 2021 janë më të ulta që nënkupton që nuk është bërë progres në rritjen e efektivitetit të mbledhjes së tatimit në prone. Në tabelat e shpenzimeve sipas drejtorive shihet se përqindja e realizimit të buxhetit nuk është aspak korrekte dhe në fund dalin rezultate jo reale. P.sh. kemi pas përqindje shumë të ulta 1-5 % te drejtoria e kulturës, urbanizmit, bujqësisë, shërbimeve publike. Si rezultat i kësaj është ulur përqindja në masë të madhe e realizimit të shpenzimeve krahasuar me buxhetin sepse analiza e tabelave është pare se shifrat e planifikimit të buxhetit për tre mujor në shumicën e tabelave janë të njejtat shifra në planifikim e buxhetit total për vitin 2023. Pse ka ndodh një pasqyrim kaq jo real në këto tabela? Në tabelën e realizimit të projekteve kapitale sipas fondeve burimore në faqen 16 shihet qartë se kanë qenë të planifikuara për tre mujorin e pare nga granti qeveritar mbi 5 milion kurse janë shpenzu rreth 50.000 euro që nënkupton që ka arritur me përqindje vetëm 1 %. Pse kjo përqindje është kaq e ulët dhe çka ju ka ndaluar që të shfrytëzohet buxheti për realizimin e këtyre projekteve?

**Labinot Halitjaha** - është e vërtetë që viti 2021 dhe 2022-ta ka pas një dallim. Në vitin 2022 ka pas një ulje te të hyrave vetanake ku është bërë debat këtu shumë here. Ka pas një lloj inflacioni 20% ku njerëzit së pari ju është dasht me kriju të ardhura për jetesë e pastaj edhe pjesa e tatimit. Këtë vit kur ta krahasojmë tre mujorin e periudhës së parë 2021 me 2023, është afërsisht 120.000 euro vetëm periudha e tre mujorit të pare. Sa i përket pjesës së tatimit në prone, këtë vit dhe vitin e kaluar kemi pas marrëveshje me postën e Kosovës dhe posta I ka shpërnda. Posta e ka një problem ku e kanë vonu pjesën e faturave dhe kjo ndikon edhe te të hyrat vetanake. Për pjesën e investimeve kapitale ku the që është një pjesë e vogël e shfrytëzuar, kështu na keni thënë edhe vitin e kaluar por deri në fund të viti mbi 90 % është shfrytëzuar buxheti i investimeve kapitale dhe besoj që këtë vit do ti shfrytëzojmë edhe më shumë.

**Elmaze Bytyqi** - dua të ndërlihem te pyetja që bëri Flamuri. A ka pas edhe vitin e kaluar shujta dhe ku janë shpenzu nëse ka pas?

**Remzi Bajselmani** - jo, vitin e kaluar nuk kemi pas si Komunë.

**Urim Suka** - gjatë vitit që ne e kemi lënë pas, ku ne kemi diskutu për raportin, ju keni thënë që tash s'kemi me pas më shumë telashe sepse i kemi bërë disa kontrata dy vjeqare dhe menjëherë mund të fillojmë ekzekutimin e buxhetit. Në disa vendbanime ju i keni disa kontrata dy vjeqare dhe më vie çudi se pse nuk keni fillu. A e dini cili është çëllimi? Nëse filloni punë më herët dhe e shpërndani rrjedhën e parasë çdo tre mujor, i bie më mirë biznesit por edhe mbikqyrësit sepse ka punë më pak dhe kohë më shumë dhe cilësia mundet me u rrit. Edhe pse këtë vit e keni këtë mundësi, ju nuk e keni shfrytëzuar këtë mundësi dhe keni bërë vetëm 1 % të parasë publike edhe pse kohën e keni pas me diell dhe në janar keni mundur të punoni. Kjo i

bie që edhe cilësia e punimeve ka me u dëmtu, edhe firmave ka me ju ra keq te rrjedha e parasë nëpër muajt dhe në fund krejt keni me i hargju si në vitin 2022 duke i deviju nëpër projekte. Kjo po tregon edhe për një paaftësi qeverisëse që ju e keni dhe të devijimit të projekteve. Urojmë që muajt tjerë kjo të merret parasysh dhe të paktën 6 mujori mos të jetë me 9 % ose me 10 %.

### **Pika 8. Shqyrtimi i peticionit;**

**Kryesuesi** - I njofton me pikën dhe fjalën ia jep Selman Kolgeci si parashtues i kësaj kërkesë.

**Selman Kolgeci** - sot kam nderin të paraqes një kërkesë të veçantë nga se ka të bëjë me njeriun që përfaqëson vlerat më të veqanta historike të Republikës së Kosovës. Në emër të qytetarëve të Komunës sonë, nënshkrues të peticionit dhe në emër të LDK-së dega në Suharekë ripërsërisim propozimin tonë e të qytetarëve që pikërisht në sheshin “Dr. Ibrahim Rugova” në Suharekë të vendoset shtatorja e të parit të Republikës, atit themeltar të shtetit të Kosovës, presidentit historik dr. Ibrahim Rugova. Thellësisht të bindur se figura e presidentit gëzon nderim dhe respect të madh tek qytetarët, falemderues për veprën dhe kontributin e tij në krijimin e shtetit të Kosovës, konsiderojmë se vendosja e shtatores në sheshin që me krenari bart emrin e tij, do ti bënte nder qytetit të Suharekës, do ti bënte nder të kaluarës, të tashmes e të ardhmës Suharekës. Të nderuar kolegë, jam I bindur që shtatorja e presidentit historic Ibrahim Rugova do t’ia shtoj vlerën akoma më shumë qytetit tonë. Po ashtu do t’ia shtoj vlerën edhe punëve të mira që janë realizuar që nga koha e bashkëveprimtarit e bashkëmendimtarit të presidentit, Kryetarit të pavdekshëm Ukë Bytyçit. Të nderuar kolegë, anëtar të Kuvendit Komunal të Suharekës, sheshi qëndror i qytetit tonë bart me krenari emrin e tij, po as një element në këtë shesh momentalisht nuk lidhet me figurën e presidentit Rugova. Nëse e shohim këtë shesh nuk mund të dallojmë se aty ka elemente që shprehin butësinë, karakterin, intelektualitetin, mirësinë, miqësinë e shumë karaktere tjera që na japin të kuptojmë që ky shesh lidhet me figurën e presidentit Rugova. Ne me këtë nismë nuk po kërkojmë ndërtimin e një püstamenti, obilisku apo shtatore klasike por po kërkojmë që në këtë shesh përmes kësaj shtatore të pasqyrohen vlerat kombëtare, vlerat e personalitetit të Presidentit Rugova. LDK, dega në Suharekë ka organizuar peticion prej qytetarëve ku në një afat të shkurtë janë mbledhur nënshkrime e nevojshme që kjo çështje të diskutohet në Kuvend e që do të dëshironim të jetë hapi i fundit për këtë temë dhe në këtë seancë të miratohet kjo kërkesë. Prandaj uroj dhe besoj që kjo kërkesë të gjej përkrahjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe kjo pike të miratohet.

**Kryetari** - është e vërtetë që peticionet janë e drejtë ligjore. Unë dua të them që historinë e Kosovës e bëjnë dy figura dhe një figure është rezistenca e paarmatosur në krye me presidentin Ibrahim Rugova dhe periudha tjetër është me Adem Jasharin. Si kryetar i Komunës respektoj çdo person që ka dhënë për këtë vend, duke i përfshi të gjitha gjeneratat por kuptohet që Ibrahim Rugova dhe Adem Jashari janë fytyrat më emblematike të Republikës së Kosovës. E drejtë e çdo qytetari dhe asambleistave është të japin propozimin dhe kështu që ky vendim ka ardhë në Asamble dhe dëshiroj me kalu. Respekt për të gjithë ata që kanë kontribu! Dua të ju them që ka qenë kërkesa edhe për Xhemajl Rexhën, Adem Jasharin, Tahir Sinanin, Ram Bllacën, ka qenë kërkesa e PDK edhe për Endrit Carën. Për mua kanë të gjithë respekt pa dallim.

**Urim Suka** - dua ti bëj thirrje secilit që këtë çështje ta kalojmë sa më mire dhe sa më të unifikuar sepse është një figure që duhet të na unifikoj të gjithëve për shkak të kontributit dhe historisë ndër vite dhe për themelimin e shtetit tonë. U befasova me fjalët e Kryetarit për shkak të qëndrimit që e keni pas në KPF por sidoqoftë është mirë kur reflektoni. E përgëzoj Kryetarin për këtë fjalë që e ka mbajtur dhe uroj që ky fjalim i tij të reflektoj edhe tek asambleistët dhe ta kalojmë bashkarisht një vendim të tillë.

**Shefket Kolgeci** - Kryetari më impresionoi me këto fjalë që i tha dhe tha që ka pas edhe kërkesa tjera. Të gjithë ata që kanë dhënë jetën për liri, dëshmor, hero, martir, të gjithë ata kanë merita për lirinë të cilën e gëzojmë ne sot por kërkesa jonë, unë nuk mendoj që është vetëm kërkesë e LDK-së. Kjo duhet të jetë kërkesë e të gjithë popullit, gjithë qytetarëve të Therandës. Merita e Presidentit Ibrahim Rugova dhe merita e komandantit legjendar Adem Jashari është e pazëvendësueshme. Ne jemi me fat që i kemi pas këta njerëz që na kanë udhëheq deri në çlirimin e vendit tonë. Andaj ju bëj thirrje të gjithë asambleistëve, pa dallim partie, pa dallim feje, të reflektojnë dhe të votojnë. Pse mos të vendoset edhe shtatorja e Adem

Jasharit në Therandë? Në çdo moment që paraqet dikush një kërkesë, unë do të jem I pari që do ta votoj edhe shtatoren e Adem Jasharit por edhe shtatoren tjera.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 8.

**10 për, 16 kundër, 3 apstenime**  
**Nuk miratohet pika 8**

**Urim Suka** - me qenëse ju e sidomos Kryetari që dol dhe mbajti fjalim emocionues, një temë kaq të rëndësishme e kthen në kaq hajgare dhe flet tjetër gjë dhe i ka shtrëngu mire këta asambleista me votu tjetër gjë. Ne nuk besoj që për sot kemi nevojë me vazhdu seancën.

**Pika 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - pasi nuk ka pyetje e mbylli takimin.

Takimi përfundoi: 12:25

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj